

George Steiner

NË KËSHTJELLËN E MJEKËRKALTRIT

(Shënime për një ripërcaktim të kulturës)

Përmbajtja

1. Mërzia e madhe	7
2. Stina e Ferrit	29
3. Post - Kultura.....	53
4. Nesër.....	85

“Shënime për një ripërcaktim të kulturës”: ky nëntitull, natyrisht, u bën jehonë *Shënimeve* të T. S. Eliotit, botuar më 1948. Një libër i pakëndshëm që poeti e shkroi të nesërmen e një epoke barbare, por pa denjuar të hedhë dritë mbi burimin dhe trajtat e njëmendta të barbarisë. Megjithatë, *Shënimet për një ripërcaktim të kulturës* nuk e kanë humbur interesin. Ato janë, pa dyshim, përftesë e një mendjemprehtësie të jashtëzakonshme. Në esenë time unë do t’u kthehem çështjeve që shtron Elioti nëpërmjet apologjisë së tij të rendit.

Nuk është vetë e kaluara që sundon mbi ne, përveçse, ndoshta, biologjikisht. Janë përfytyrimet e së kaluarës. Këto janë shpeshherë po aq fort të strukturuar, po aq të rrepta sa dhe vetë mitet. Përfytyrime e konstrukte të ndryshme simbolike janë gdhendur në ndjeshmërinë tonë pothuajse ashtu si informacioni gjenetik. Çdo epokë e re e sodit vetveten në pasqyrën e përfytyrimeve të gjalla të historisë së vet, ose të një të kaluarë që e huan nga ndonjë kulturë tjetër. Aty, përkundrajt të kaluarës, ajo vë në provë identitetin e saj, ndjesinë e saj të progresit apo të regresit. Ato jehona, ku shoqëria kërkon të përcaktojë fuqinë, logjikën dhe ndikimin e zërit të saj, vijnë që andej. Afërmendsh, mekanizmat që veprojnë janë të ndërlikuar dhe ushqehen nga një nevojë e turbullt, por gjithsesi jetike, për vazhdimësi. Shoqëria nuk mund të bëjë pa paraardhës. E nëse këto nuk gjenden lehtë, si në rastin e një bashkësie të sapolindur, apo të restauruar mbas një periudhe të gjatë shprishjeje ose skllavërie, në gramatikën e qenies krijohet, me hir të mendjes dhe të zemrës, një kohë e shkuar e domosdoshme. “Historia” e zezakëve amerikanë apo ajo e Izraelit përbëjnë shembuj mjaft të mirë. Dhe, mesa duket, motivi i mbramë ndoshta është metafizik. Historia, më së

shumti, bart mbi shpinë reliktet e parajsës. Dikur, në kohëra pak a shumë të largëta, bota ka qenë më e mirë, pothuajse e artë. Mes njeriut dhe natyrës që e rrethonte, kishte një harmoni të thellë. Miti i Rënies mbetet më i fuqishëm se çdo fe e veçantë. Vështirë të ketë ndonjë qytetërim, apo madje ndonjë ndërgjegje individuale, që nuk ngërthen jehonën e një katastrofe të largët. Diku në “pyllin e errët e të shenjtë” është bërë një kthesë e keqe dhe njeriu paskëtaj ka qenë i shtrënguar, në kundërshtim me natyrën e vetë qenies, të rropatet në ndeshjen me shoqërinë dhe me vetveten.

Për kulturën e sotme perëndimore ose “post-kulturën”, kjo utopi kaq e shpërdorur është tepër e rëndësishme. Por ajo është modernizuar dhe bërë laike. Turbullira që na ka pushtuar, ndjesia se po zhytemi sërishmi në një botë dhune, në një topitje të moralit; përshtypja jonë e fortë e zhdukjes së vlerave artistike, e normave vetjake dhe shoqërore; frika që kemi se po kthehet një “epokë e errët” që do ta zhbëjë qytetërimin, ashtu siç e kemi njohur ne, ose prej tij do të mbeten vetëm ndoca ujdhesa të vogla, si mbeturina arkaike - të gjitha këto frikë, aq të dukshme e të shpallura me zë të lartë sa janë bërë klishe e shpirtit të kohës, e gjejnë forcën dhe besueshmërinë e vetvetishme tek krahasimi. Prapa frymës së sotme të dyshimit dhe vetëposhtërimit fshihet prania - aq e tejdukshme sa që askush nuk ndalet ta shqyrtojë - e një të kaluarë të veçantë, e një “kohe të artë”. Përjetimi ynë i së tashmes dhe mendimi ynë shpeshherë aq negativ për vendin që zëmë në histori, burojnë nga një luftë e vazhdueshme ndaj asaj që dëshiroj ta quaj “miti i shekullit XIX”, ose “kopshti imagjinar i kulturës liberale”.

Na është bërë shprehi ta vendosim këtë kopsht në Angli dhe në Evropën perëndimore midis viteve 1820 dhe 1915. Data e fillimit mbetet në anonimatin e konvencionit, por fundi i asaj vere të gjatë ka një saktësi apokaliptike. Elementet e dekorit janë mëse të njohura. Niveli i lartë dhe gjithnjë në rritje i shkollimit. Rendi ligjor. Një përhapje gjithnjë e më e madhe, ndonëse në mjaft vende padyshim në gjendje fillestare, e formave demokratike të qeverisjes. Respektim i jetës private dhe siguri gjithnjë e në rritje në vendet publike. Njohje e vetvetishme e rolit parësor, ekonomik dhe qytetëruar të arteve, shkencave dhe teknologjisë. Arritje, herë-herë e vështirë, por gjithmonë e kërkuar e bashkekzistencës paqësore ndërmjet kombeve sovrane (që nga Vaterloja deri tek beteja e Somës, këto përpjekje, me disa përjashtime të rralla, kanë qenë përherë të suksesshme). Një ndërveprim dinamik, i zbutur nga humanizmi, midis mundësive për të ngjitur shkallët e shoqërisë dhe qëndrueshmërisë së vijave të forcës e kufijve ndarës të përcaktuar nga zakoni shoqëror. Moral autoritar, ndonëse tradicionalisht i moderuar, në raportet ndërmjet brezave, mes etërve dhe bijve. Tolerancë seksuale, gjithsesi brenda disa caqesh të respektuara, por jo të ngurta të konvencionit. Mund të vazhdoja edhe më. Lista mund të zgjatet fare mirë e të bëhet më e hollësishme. Por desha të tregoj se nga e tërë kjo del një përfytyrim i larmishëm dhe mbresëlënës, një strukturë simbolike që, me forcën e një mitologjie vepruese, e përuddh ndjeshmërinë tonë të sotme.

Në varësi të interesave tona, secili prej nesh bart në vetvete copëza e pjesë të ndryshme nga kjo tërësi komplekse. Prindi “di” për një kohë kur mënyrat e sjelljes ishin të ngurta dhe fëmijët trajtoheshin rreptë. Sociologu “di” për një qytetërim urban që nuk e njihte rrezikun e anarkisë dhe të tallazeve të dhunës. Njeriu fetar dhe moralisti “dinë” për një epokë të largët vlerash të pranuar nga të gjithë. Çdonjëri prej nesh mund të evokojë ato pamje që i vijnë për shtat: shtëpinë ku mbretëron rregulli dhe me kthina të veçanta për shërbëtorët; parqet me shëtitjet e së dielës, aq çlodhës e aq të sigurt; latinishtja nëpër klasat e shkollës dhe stërhollimet e argumenteve të pakundërshtueshme nëpër auditorë; librari për të qenë dhe debate parlamentare të mençura. Njerëzit e kulturuar “dinë”, në kuptimin e ngushtë e simbolik të përcaktuar të fjalës, për një kohë kur krijimet serioze, letrare apo diturore, shiteshin me çmime të pranueshme dhe rroknin një publik të gjerë apo të ngritur. Edhe sot e kësaj dite janë gjallë shumë njerëz për të cilët vera me qiell të pastër e 1914-ës ka zënë fill diku prapa, diku larg, në një botë më të qytetëruar, me më shumë besim në vetvete, me një shprehje më humane sesa ajo që kemi parë qysh nga ajo kohë. Janë kujtimet e asaj vere të madhërishme, si dhe shëmbëllimi i saj simbolik në dijen tonë, që na bëjnë të përjetojmë kësisoj acarim e së sotmes.

Nëse ndalemi për të parë se nga buron kjo dije, do të shohim se burimet e saj më së shpeshti janë letërsia dhe piktura, se përfytyrimi i shekullit XIX brenda nesh ushqehet nga Dikensi apo Renuari. Po të dëgjojmë historianët, sidomos ata të majtët, kuptojmë menjëherë se “kopshti imagjinar”, në disa aspekte të rëndësishme, nuk është gjë tjetër veçse

përrallë. Ata na tregojnë shkoqur sesi nën prarimin e jashtëm të një bote tepër të qytetëruar fshiheshin plagë të thella të shfrytëzimit ekonomik; sesi etika seksuale borgjeze ishte një fasadë që maskonte një dyfytirësi me përmasa të mëdha e krejt të paskrupullt; se fare të paktë ishin ata që vërtet mund të quhen të kulturuar; se urrejtja midis brezave dhe klasave, sado e heshtur, ishte tepër e thellë; se qetësia e lagjeve të pasura dhe e parqeve paguhej me rrezikshmërinë e lejuar, por të kontrolluar, të lagjeve të varfra. Kushdo që do ta merrte mundimin të rrëmonte pak, do të shihte se si ka qenë dita e punës në një fabrikë të epokës viktoriale dhe se ku arrinte shifra e vdekshmërisë së fëmijëve në rajonet minerare të Francës veriore ndërmjet viteve 1870-1880. Është e pamundur të mos shohësh se pasuria shpirtërore dhe stabiliteti i jetesës së borgjezisë së mesme dhe të lartë në atë stinë të gjatë të verës së liberalizmit mbështetej drejtpërdrejt në sundimin ekonomik dhe, tekembranja, në sundimin ushtarak të një pjese të madhe të atyre vendeve që sot quhen të pazhvilluara, apo të Botës së Tretë. Të gjitha këto duken sheshit. Dhe ne e pranojmë këtë në çastet kur jemi të arsyeshëm. Ndërkaq, në pulsimin e brendshëm të ndjeshmërisë sonë, kjo lloj kthjelltësie është krejt kalimtare dhe nuk zë aq vend sa miti i një kopshti madhështor qytetërimi të dikurshëm dhe tashmë të shkretuar, - një metaforë e kristalizuar kjo, e përgjithësuar dhe pa të çara.

Deri diku është vetë shekulli XIX që ka përgjegjësi për këtë fantazi të përmallshme. Deklaratat e tij zëlarta mund të përbëjnë antologjinë e një krenarie kokëngjeshur dhe të vetëkënaqur. Tingujt e *Locksley Hall*-it të Tenisonit kumbojnë shpesh në kohëra dhe vende nga më të ndryshmet. Ato mund t'i dëgjojmë edhe në esenë mbi Bekonin, shkruar nga Mekouli më 1837, në elozhin e tij të famshëm për horizontet e reja të shkencës:

“Ajo e ka zgjatur jetën; e ka zbutur vuajtjen; i ka zhdukur sëmundjet; e ka rritur pjellorinë e tokës; i ka sjellë më shumë siguri detarit; i ka dhënë armë të reja luftëtarit; ka hedhur mbi brigjet e grykëderdhjet e gjera të lumenjve ura me aso trajtash që etërit tanë s'i kanë parë ndonjëherë; e ka rrokur shkreptimën e qiellit dhe, pa bërë dëm, e ka futur në dhe; e ka zbardhur natën me dritën e ditës; e ka shtrirë cakun e shikimit të njeriut; e ka shumëfishuar fuqinë e muskujve të tij; e ka përsheptuar lëvizjen; e ka asgjësuar largësinë; i ka lehtësuar marrëdhëniet, letërkëmbimin, përkujdesjet miqësore, drejtimin e punëve; i ka krijuar njeriut mundësinë për të zbritur në fund të detit, për t'u ngjitur në qiell, për ta përshkuar botën me mjete që lëvizin pa kuaj, për të kapërcyer oqeanet me anije që ecin kundër erës me dhjetë milje në orë. Këto janë vetëm disa nga frytet e saj dhe vetëm nga të vjelat e para; sepse filozofia e saj nuk ka të ndalur, nuk është e dhënë njëherë e mirë, nuk është kurrë e përkryer. Ligji i saj është progresi”.

Apoteoza përmyllëse e Pjesës së Dytë të *Faustit*, historicizmi hegelian me doktrinën e tij të Frymës që realizon vetveten, pozitivizmi i Ogyst Kontit, kulti filozofik i shkencës i Klod Bernarit, janë që të gjitha shprehje të një kthjelltësie dinamike, të të njëjtit besim në epërsinë e dukshme të faktit. Ne sot i shikojmë këto me një habi të përzier me ndjenjë humori.

Por ka edhe epoka të tjera që kanë lënë pas vetes përfytyrime mbivlerësuese. Përfytyrimi i pashqitshëm i një harmonie të humbur, i një qendre të dikurshme rrezatuese, ka më tepër forcë sesa e vërteta historike. Faktet mund t'i bien ndesh, por jo ta zhdukin. Ai i përgjigjet një nevojë të thellë psikologjike dhe morale. Na jep njëfarë drejtpeshimi, sepse është kundërpeshë dialektike e vetë gjendjes sonë. Mesa duket, kemi të bëjmë me një proces të pashmangshëm, pothuajse organik. Po kështu, edhe bashkëkohësit e perandorisë romake i kthenin sytë nga pamjet utopike të virtytit republikan; atyre që kishin njohur *ancien regime* u dukej se vitet e fundit të jetës po i kalonin nën zgjedhë. Në makthet e zymta të së tashmes është endur hollë filli i ëndrrave plot dritë. Unë nuk dua as t'i kundërvihem këtij mekanizmi, as të shtjelloj një “tablo autentike” të së kaluarës liberale. Do të përpiqesha vetëm ta vështroja “verën 1815-1915” nga një kënd tjetër. Jo si tërësi simbolike me vlera që bëjnë kontrast me telashtet tona dhe na lëshojnë mallkimin, por pikërisht si burimi i këtyre telasheve. Mendimi im është se disa nga farërat e çnjerëzores, të krizës së kohës sonë, çka na detyron ta ripërcaktojmë kulturën, gjenden në atë paqe të gjatë të shekullit XIX, madje në vetë indin kompleks të qytetërimit.